

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush fiton IA-në, fiton gjithçka! - 'Supreme apo Ekstreme', Trump propozon ndryshimin e emrit të Inteligj encës Artificiale! Së shpejti
ADRESA	https://www.syri.net/bote/917916/supreme-apo-ekstreme-trump-propozon-ndryshimin-e-emrit-te-inteligjences-artificiale-se-shpejti-ai-force/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 20:25:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 20:07:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	91c215fca2e2426cfd8a11eeeb0d37c26403daaff427c3d168cda8485dc19f24
TEKSTI	3d8bbc4b5a9c1f26705092628383ecaba393106a1243109e369cdbe8f66670bd
PAMJA	c4b884e6a24b972b1e6cdb1a0852d20b65fe317f4b185bc2f28b12f36b972cb9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	804b7f60c486664fced894cefcf1a784a912460b5f11c6bef40fb75e9dcc5695
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	552a34f0419bb0f85ba237bcc1ccacbd9efdbebeb1d3d406ed195c7fa79d55c7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.


Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/804b7f60c486664fced894cefcf1a784a912460b5f11c6bef40fb75e9dcc5695>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER ROBELLI**
Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshtja e Tiranës**NDRIÇIM KULLA**
Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit
siamezë të dekadencës
demokratike evropiane

‘Supreme apo Ekstre’, Trump propozon ndryshimin e emrit të Inteligjencës Artificiale! Së shpejti 'AI Force'

22:07, 19/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, njoftoi të shtunën se do të emërojë një koordinator të posaçëm për inteligjencën artificiale (AI), dhe se do të krijojë gjithashtu një 'grup të posaçëm pune për këtë teknologji.

Nisma vjen pasi studiues të inteligjencës artificiale kanë paralajmëruar se zhvillimi i saj mund të dalë së shpejti jashtë kontrollit njerëzor, duke nxitur shqetësime dhe thirrje për rregullimin e industrisë.

Në një postim në rrjetet sociale, Trump tha se nuk do të lejojë "shkatërrimin" e inteligjencës artificiale.

"Nuk do ta pengojmë apo frenojmë në asnjë mënyrë rritjen e kësaj industrie të jashtëzakonshme. Përkundrazi, do ta mbështesim, do ta ndihmojmë dhe do ta mbikëqyrim teksa zhvillohet! Megjithatë, do të jemi gjithashtu në kërkim të abuzimeve dhe kjo mund të bëhet lehtësisht përmes sistemit tonë ekzistues të drejtësisë penale dhe civile. Për këtë qëllim po krijoj AI Force, ashtu siç krijova Space Force", shkroi Trump në Truth Social.

Trump shtoi se për postin e koordinatorit (anglisht czar role) të AI-së duhet të aplikojnë "vetëm individë me inteligjencë shumë të lartë", por nuk bëri të ditur se kush do ta mbajë këtë detyrë.

Gjatë dy javëve të fundit, Trump i ka quajtur një "mashttrim" paralajmërimet për rreziqet e inteligjencës artificial duke deklaruar se prioriteti duhet të jetë që SHBA-ja të udhëheqë botën në zhvillimin e AI-së dhe të mposhtë Kinën në këtë garë.

"Kush fiton garën AI-në, fiton gjithçka", ka deklaruar Trump disa herë gjatë javës së fundit.

Përmes një serie postimesh në rrjetet sociale, presidenti amerikan mbroiti

më të lexuarat

Vrasje brutale në Kolumbi! Autorja i zuri pritë para biznesit, biznesmeni 61-vjeçar, qëllohet me 11 plumba

VIDEO/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të ikte

Pakistani dënon përpjekjen 'e neveritshme' për sulm me dron pranë Mekës

Bolivia miraton programin 1.9 miliardë dollarësh të FMN-së, qeveria angazhohet për reforma ekonomike

Forcat izraelite tërhiqen nga qyteti perëndimor i Sirisë pas një ofensive disa orëshe

Ushtria izraelite nis sulme të reja në Libanin jugor pavarësisht marrëveshjes kornizë

fuqishëm teknologjinë e inteligjencës artificiale. Ai madje telefonoi drejtorin ekzekutiv të Nvidia-s, Jensen Huang, ndërsa ky i fundit ishte në skenë gjatë një samiti të industrisë për të diskutuar mbi këtë çështje.

Shtëpia e Bardhë nuk ka dhënë ende detaje të mëtejshme mbi iniciativën e re të Trump.

Ndërkohë, përpjekjet e ligjvënësve amerikanë për të miratuar legjislacion mbi inteligjencën artificiale nuk kanë dhënë rezultat në vitet e fundit. Megjithatë, çështja është rikthyer sërish në qendër të debatit pas paralajmërimeve të reja nga ekspertët.

Gjatë një takimi me dyer të mbyllura në Kongres këtë javë, laureati i Nobelit Geoffrey Hinton, i njohur si "babai i inteligjencës artificiale", paralajmëroi ligjvënësit se koha për të rregulluar industrinë po mbaron. Ai tha se Kongresi ka "ndoshta vetëm një vit" për të vepruar, shkruan [NBC News](#)

Në një tjetër postim propozoi edhe ndryshimin e emrit. Trump nisi një sondazh me tre propozime, ku ndjekësit duhet të zgjedhin, duke argumentuar se termi aktual Inteligjencë Artificiale është "i pasaktë" dhe jo elegant.

Sipas presidentit të SHBA-së, përkufizime më të përshtatshme mund të jenë "Inteligjencë Superiore", "Inteligjencë Ekstreme " ose "Inteligjencë Supreme ".

"Shumë njerëz mendojnë se fjalët "Inteligjencë Artificiale" janë të pasakta.

Një përshkrim shumë më elegant dhe i saktë i këtij fenomeni të ri do të ishte Inteligjencë Superiore (SI) ose Inteligjencë Ekstreme (EI) ose Inteligjencë Supreme (SI). Ky është një Sondazh dhe do të vlerësoja të gjithë ata që votojnë!", shkroi ai.



Many people think that the words "Artificial Intelligence" are inaccurate, and very ineloquent, relative to AI, or Artificial Intelligence. A far more elegant and accurate description of this new phenomena would be Superior Intelligence (SI) or, Extreme Intelligence (EI) or, Supreme Intelligence (SI). This is a Poll, and I would appreciate everybody voting! Which is the best name for this ever growing "Revolution?" President DONALD J. TRUMP



Trump kishte më parë një koordinator për inteligjencën artificiale dhe kriptovalutat, David Sacks, i cili u largua nga posti në fillim të këtij viti për shkak të kufizimeve të mandatit të tij si punonjës i posaçëm qeveritar. Sacks vazhdon të ketë një rol këshillimor në administratë dhe pritet të marrë pjesë në darkën shtetërore të Trump me presidentin kinez Xi Jinping.

Ndërkohë, disa figura demokrate që konsiderohen si kandidatë të mundshëm për zgjedhjet presidenciale të vitit 2028 kanë ndërmarrë hapa për rregullimin e inteligjencës artificiale në nivel shtetëror.

Edhe ish-presidenti Barack Obama u ka kërkuar demokratëve që të hartojnë një plan të qartë për inteligjencën artificiale, duke thënë se do ta kishte bërë këtë një nga temat kryesore të fushatës së tij nëse do të kandidonte në zgjedhjet e vitit 2028.

© SYRI.net

Tava edhe

Sulmet me dronë dhe raketa nga Irani/ SHBA thirrje amerikanëve: Rishqyrtoni udhëtimet në Arabinë Saudite

Filipine/ 6 nxënës të vrarë dhe 17 të tjerë të plagosur nga të shtënkat në një shkollë të mesme

'Më kërcënuan se do të vrisnin nënën time', Rrëfimi i artistes: Si më urdhëruan të spiunoj dhe të ndihmoj në vrasjen e armikut të Kremlinit

2019-08-01



Militantët Houthi marrin përsipër sulmin ndaj kryeqytetit saudit, pas shpërthimit pranë aeroportit të Riadit



NATO mirëpret marrëveshjen për Groenlandën, Trump: SHBA do të ketë kontroll të përhershëm të sigurisë



Alarm në Arabinë Saudite, shpërthime pranë aeroportit të Riadit

TË NGJASHME



Trump u kërkon prodhuesve të barnave t'i ndajnë vaksinat në pesë doza për të parandaluar autizmin



I akuzuar për spiunazh në favor të Izraelit, Irani ekzekuton një tjetër të dënuar



Trump e nënshkruan ligjin për sanksione ndaj Rusisë e Iranit, shton mjete të reja për trysni



Izraeli kërkon 'kompensim' nga SHBA, rriten tensionet mes aleatëve



Putin pas deklaratave të liderëve të BE-së: Rusia nuk ka qëllime agresive, gati për të rivendosur marrëdhëniet



Danimarka: Groenlanda nuk heq dorë nga sovraniteti i saj pas marrëveshjes me SHBA-në



Tragjedi në Qipro, 22-vjeçari i njohur i rrjeteve sociale gjendet i pajetë në pishinë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MUZIKË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.